



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

31 tetor 2022

Nr. ____ prot.

Drejtuar: Z. Eduart Shalsi,
Kryetar
Komisioni për Ekonominë dhe Financat
Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Znj. Delina Ibrahimaj
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë

Objekti: Komente të anëtarëve të Dhomës Amerikane të Tregtisë në lidhje me Paketën
Fiskale 2023

Te nderuar Z. Shalsi dhe Znj. Ibrahimaj,

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (në vijim referuar si "Dhoma") në funksion të misionit të saj për të ndihmuar bizneset të punojnë në një klimë të qëndrueshme dhe konkurrencë të ndershme, e konsideron me rëndësi të madhe procesin e ndryshimeve mbi projektligjet për Paketën Fiskale 2023.

Në përgjigje të materialit mbi ndryshimet e reja ligjore që iu parashtruan biznesit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë mbledhjes së Këshillit Tatimor të mbajtur më datë 10 tetor 2022, Dhoma ju bën me dije se:

së pari, një pjesë e madhe e bizneseve anëtare, kanë reaguar me shqetësim, në lidhje me këto projektligje, komente të cila u shprehen edhe gjatë takimit të Këshillit Tatimor;

së dyti, koha e vënë në dispozicion të grupeve të interesit nuk ka qënë e mjaftueshme që ekspertët të zhvillojnë një analizë të plotë për të prodhuar komente të detajuara për draftin.





AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

Përsa më sipër, Dhoma shpreh shqetësimin mbi procesin e ndjekur deri më tani nga qeveria për aprovimin e Paketës Fiskale 2023 dhe konstaton një shkelje të përsëritur të afateve të Ligjit mbi Konsultimin Publik. Dhoma Amerikane vëren e zhgënjyer se kjo paketë mjaft e rëndësishme për biznesin u prezantua gjatë Këshillit Tatimor të mbajtur në 10 tetor 2022 dhe u publikua për herë të parë në faqen e konsultimeve publike në datën 12 tetor 2022, duke i lënë një hapsirë palëve të interesuar për të dërguar komentet e tyre deri më datë 12 nëntor 2022. Ndërkohë, konstatuam në faqen zyrtare të Kryeministrisë se këto projektakte janë shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të mbajtur më datë 26 tetor 2022. Menjëherë në ditën në vijim, më datë 27 tetor 2022, këto projektligje janë bërë pjesë e rendit të ditës së Komisionit për Ekonominë dhe Financat, pranë strukturë pranë Parlamentit. Kjo praktikë e ndjekur (e përsëritur) është një shkelje e hapur e ligjit.

Referuar ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”, autoritetet shtetërore duhet t’i ofrojnë palëve të interesuara një periudhë kohore të përcaktuar për të shqyrtuar dhe ofruar rekomandimet e tyre në lidhje me projektligjin/et e propozuar.

Bazuar në Vendimin nr. 584, datë 28.8.2003 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave, kreu VI, në përfundim të procesit të hartimit dhe të bashkërendimit me mendimet e ministrave dhe të drejtuesve të institucioneve të interesuara, ministri propozues paraqet projektaktin për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Projektakti, relacioni shpjegues, dhe gjithë dokumentet e përcaktuara në rregullore, në dy kopje origjinale, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, të paktën 10 dite përpara datës së caktuar për mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Për ne është e paqartë se si kjo paketë i është paraqitur për shqyrtim Këshillit të Ministrave dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, pa marrë dokumentin konsultativ, pasi afati i konsultimit publik përfundon në 12 nëntor 2022.

Përsa më sipër, Dhoma Amerikane kërkon shtyrjen e afatit të shqyrtimit të projektligjeve, nëpërmjet zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin publik”, duke i lënë mundësi grupeve të interesit të ushtrojnë të drejtën e tyre duke u njohur me përmbajtjen e ligjit dhe ofrimin e sugjerimeve për përmirësimin e tij.

Në vijim, Dhoma Amerikane shpreh bindjen se projektligjet kanë nevojë për përmirësim, i cili do të mundësohej pas reflektimit të rekomandimeve të komunitetit të biznesit. Një pjesë e problematikës po jua përcjellim bashkëngjitur më këtë letër, duke i ndarë komentet tona në dy seksione; **Seksioni I** përfshien komentet në lidhje me ndryshimet e propozuara nga projektligjet specifike, ndërsa **Seksioni II** përfshin rekomandime të tjera.

Drejtori Ekzekutiv
Neritan Mullaj



SEKSIONI I

KOMENTET E DHOMËS AMERIKANE MBI PAKETËN FISKALE 2023

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar”.

- Përkufizime

Neni 1 parashikon disa terma të rinj dhe ndryshime, në mënyrë që të jenë në linjë me termat e përdorur në ligjin ‘Për tatimin mbi të ardhurat’.

Termit individ i vetëpunësuar dhe individ tregtar duhet të rishikohen edhe njëherë për të krijuar një përkufizim të unifikuar. Kujtojmë se sipas Kodit Civil, ai që përkufizohet si “individ” në legjislacionin tatimor në fakt përkufizohet “si person fizik” ndërsa ligji tregtar i quan “persona fizike tregtare” ata persona fizike që zhvillojnë veprimtari ekonomike.

Në keto kushte, legjislacioni tatimor duhet të rishikohet me Kodin Civil duke referuar në dy kategori “person fizik” dhe “person fizik tregtar” dhe pastaj mund të ndaje personat fizike në të punësuar, të vetëpunësuar etj.

Më tej, termi entitet duhet të rishikohet në tërësi pasi nuk merr në konsideratë asnjë parashikim të Kodit Civil dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nuk është në gjuhën shqipe por një term i huazuar nga gjuha angleze. Termit e përdorur, si “forme e trustit të huaj”, “strukture e ngjashme për legjislacionin shqiptar”, “entitet i natyrës personale” nuk njihen në legjislacionin shqiptar. Gjithashtu, fjala “kompani” nuk njihet në Kodi Civil dhe në Ligjin për Shoqëritë Tregtare bazë mbi të cilën rregullohen format e organizimit të shoqërive tregtare. Si e tillë, ky term duhet të fshihet nga gjithë aktet e tjera që lidhen me to apo rregullojnë aktivitetin e shoqërive tregtare.

Thëksojmë se, ndryshimi i këtyre termave ndikon edhe në kategorinë e tatimpaguesve në sistemin elektronik tatimor i duhet të reflektojë çdo ndryshim ligjorë që hyn në fuqi në fushën tatimore.

Ndërsa në nenin 127 është përdorur termi “*individë me pasuri të lartë*” për të cilin nuk është dhënë një përkufizim në ligj, gjë që do të rrisë paqartësi dhe pasiguri juridike tek tatimpaguesit.

Si konkluzion, pika k, m, n dhe o e nenit 1 të projektligjit duhet të rishikohen në tërësi për t’u riformuluar qartë, pasi ato janë të pasakta, të pabazuar në ligj, dhe duhet të shtohet një përkufizim për termin “individ me pasuri të lartë”, duke përcaktuar se çfarë konsiderohet pasuri e lartë, në varesi të natyrës së pasurisë psh pasuri e paluajtshme, aksione, para në banke, makine luksoze etj.

- Strukturat e administratës tatimore

Neni 4, i projektligjit sjell disa ndryshime në nenin aktual 16 të ligjit të procedurave, duke e përshtatur atë me ndryshimet strukturore që ka pësuar Administrata Tatimore Qendrore me Urdhrin e Kryeministrit nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”. Për shkak të rëndësisë që ka Drejtoria Teknike dhe Ligjore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet të cilës administrata tatimore jep vendime dhe interpretime ligjore thelbësore për trajtimin e transaksioneve dhe planifikimit



tatimorë, propozojmë që kjo strukture të klasifikohet si "funksion baze" dhe jo si "funksion mbeshtetes".

– Limiti i arkës

Neni 7, parashikon dispozita ligjore mbi detyrimin e tatimpaguesit për të depozituar paratë (kartëmonedhat dhe monedhat) në llogarinë bankare si dhe limitin e shumës së parave cash në arkën e tij. Gjykojmë se, ky detyrim konsiderohet një ndërhyrje në lirinë ekonomike të subjektit për të cilën nuk është bërë një analizë e hollësishme. Për disa aktivitete ekonomike të caktuara si sektori i transportit dhe shitjeve me pakicë (retail) mund të ketë një ndikim negativ të rëndësishëm, sepse kjo ndërhyrje mund të rezultojë jo proporcionale dhe shoqërohet me barrë të shtuara administrative e logjistike në të bërin biznes. Më konkretisht, aktiviteti i shoqërive shitje me pakicë të cilët punojnë me dy turne, do të hasin vështirësi në zbatimin e këtij detyrimi. Kjo vështirësi reflektohet sidomos për turnin e dytë i cili nuk do të ketë mundësi për të depozituar paratë në bankë apo në shoqëritë e ruajtjes së fondeve, për shkak të orarit të punës së institucioneve financiare. Ndërsa shoqëritë që merren me ruajtjen dhe transportimin e fondeve operojnë vetëm gjatë orëve të para të ditës për shkak dhe të kufizimeve ligjore. Këto çështje të ngritura dhe barra e shtuar për tatimpaguesin, janë risqe që duhet të analizohen nga qeveria përpara se të bëhet një ndryshim ligjor dhe duhet kuptuar dhe justifikuar me përfitimin që ka shteti për këtë procedurë, i cili nuk është i specifikuar në relacion.

Për sa më sipër, sugjerojmë që pika 1 e nenit 59/2 të riformulohet si vijon:

"Tatimpaguesi, që lëshon faturë, përveç në rastet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 59/1, të këtij ligji, mund të mbajë para cash (kartëmonedha dhe monedha) në arkën e vet në fillim të çdo dite pune deri në shumën maksimale të arkës. Shuma e parave cash është shuma fillestare e parave (kartëmonedha dhe monedha) që tatimpaguesi mund të ketë në arkën e tij në fillim të ditës së punës. Shumën maksimale të parave cash e përcakton tatimpaguesi që lëshon faturë, në mënyrë të pavarur, duke nxjerrë një akt të brendshëm, në përputhje me nevojat dhe kushtet e sigurisë, por kjo nuk mund të jetë më shumë se maksimumi i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni."

Një sugjerim tjetër është rishikimi dhe rritja e limiteve nga 2% në 3% të vlerës së arkës për kategorinë e subjekteve me xhiro mbi 10 milion. Ky sugjerim vjen nga sektori i shitjes me pakicë për të cilën në ditë të ndryshme të vitit parashikohen qarkullime të larta shitje dhe mund të kalohet kufiri i propozuar nga Ministria.

Nga analiza vjetore e disa shoqërive me shitje me pakicë për xhirot ditore të tyre, vërehet se për disa ditë specifike si psh. dite festash kombetare, muaji dhjetor apo gjatë ditëve të fushatave promovionale, ka një rritje të fluksit të shitjeve ku tejkalohet niveli prej 2%.



- Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

Neni 11, i projektligjit ka sjellë riformulimin e nenit 71/2 të ligjit Nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjuha e përdorur në këtë nen është e pakuptueshme dhe sjell paqartësi dhe pasiguri ligjore tek tatimpaguesit. Në relacion nuk është specifikuar qëllimi i këtij ndryshimi dhe për këtë arsye biznesi e ka të pakuptueshme pse kërkohet riformulimi i një neni ekzistues dhe të qartë. Formulime të tilla të përgjithshme nuk mjaftojnë, por ato duhet të jenë konkrete, specifike. Këto rregulla janë të qarta në legjislacione të Bashkimit Europian, apo edhe OECD, apo BEPS (pra, mund të merren te gatshme) duke specifikuar transaksione konkrete që kryhen midis tatimpagueve shqiptarë për shmangien e këtyre taksave.

Përsa më sipër, sugjerojmë që të rishikohet mënyra e formulimit duke identifikuar transaksionet të cilat konsiderohen si shmangie tatimore, në mënyrë që të garantohet siguria juridike dhe kompetencat me kriteret e vlerësimit të administratës tatimore të jenë më të mirë përcaktuara për mos lejuar shtigje për abuzim.

- Kontrolli Tatimor

Neni 12, 13 dhe 14 i projektligjit është në vijim të propozimeve të bëra në kuadër të kontrollit të individëve. Vëmë re se, me termin “ose njësitë e tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me funksione të njëjta me të” duplikohen kompetencat e drejtorive rajonale me struktura të tjera të cilat nuk janë të referuara qartë në ligj, gjë që sjell rritjen e pasigurisë juridike për tatimpaguesin. Ky ndryshim krijon mbivendosje të kompetencave institucionale, si dhe sjell një konflikt interesi ndërmjet sektorëve brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme ka mision administrimin tatimor si dhe menaxhimin e kontrollin e Drejtorive Rajonale. Ndërsa propozimi i bërë sjell një mbivendosje të detyrave dhe të parimeve të kontrollit/auditimit të drejtë. Ky ristrukturim do të sjellë një rrezik të lartë kundrejt pavarësisë profesionale duke lënë mundësi të moszbatimit të parimeve të administrimit tatimor.

Gjithashtu, riorganizimi i kontrollit tatimor për individët me të ardhura të larta duhet të mbetet në kuadër të rritjes së efektivitetit dhe eficiencës së mbledhjes së të ardhurave nga kapitalet direkte, dhe të mos çojë në ashpërsimin e sjelljes së administratës tatimore ndaj individëve. Nëse administrata tatimore fillon me kontrole në terren të individëve, kjo do të çonte në cenimin e privatesisë dhe tejkalimin e kompetencave nga ana e saj.

- Transferimi i shumave të parave për të paguar

Neni 15 parashikon se transferimi i shumave të parave nga llogaria e tatimpaguesit shitja/ transferimi i aktiveve ose kapitaleve të shoqërisë në këtë rast kryhet vetëm në bashkëpunim me administratën tatimore. Sugjerojmë që neni 89 të riformulohet si më poshtë:

“Transferimi i shumave të parave nga llogaria e tatimpaguesit, shitja/transferimi i aktiveve ose kapitaleve të shoqërisë në këtë rast kryhet vetëm në bashkëpunim me administratën tatimore,

per rastet kur subjekti shites i aktiveve dhe kapitaleve te shoqerise ka detyrime tatimore te pashlyera”.

Në kuptim të këtij neni, detyrohet tatimpaguesi, llogaritë e të cilit janë bllokuar nga administrata tatimore, të derdhe në banke cdo shume te arketuar. Ne vijim, bazuar ne urdher bllokim, banka do te kaloje per llogari te tatimeve cdo shume te derdhur deri sa te paguhet borxhi tatimor. Ne mendimin tone ky nen duhet ripare pasi mund te tejkaluje te drejtat e administrates tatimore ne arketimin e borxhit tatimor, duke lene te kuptohet se borxhi tatimor prevalon ndaj cdo lloj borxhi, gje qe mund te bie ne kundërshtim me rradhen e preferimit sipas Kodit Civil, ligjit per falimentimin, apo ligje te tjera.

- Rritja e gjobave për shkeljet administrative

Vëjmë re se në tërësinë e saj, kjo paketë sjell një ashpërsim të gjobave ndërkohë që në këtë kohë krize qeveria duhet të propozojë politika më lehtësuese për tatimpaguesit.

Vendosja e gjobës në masën 10% të vlerës së parapagimit, në rast vonese të pagesës së parapagimeve të tatim fitimit, të cilat për nga natyra nuk janë një tatim i maturuar, ka elementë të theksuar të mungesës së proporcionalitetit dhe duhet të shqyrtohet edhe në këndveshtrimin e kritereve të vendosura nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 33/2016.

Në vijim, projektligji propozon rritjen e penaliteteve për shkeljet administrative të kryera nga tatimpaguesit si më poshtë:

- Gjoha per mallrat e pashoqeruara me fature behet 750'000 leke nga 75'000 leke qe ishte me heret, por kallezimi penal behet ne rast se subjekti eshte perserites dhe jo ne shkeljen e pare;
- Dhjetefishimi i gjobes per mosleshim te faturave per furnizim, pagese, apo pranim te mallrave - nga 150'000 behet 1'500'000 leke;
- Gjoha per mosdeklarimin e punonjesve apo pagave reale behet 200% e detyrimit per entitetet juridike dhe 100 % e detyrimit per tatimpaguesit e tjere.

Me miratimin e ligjit për Fiskalizimin u propozua dhe u miratuan ndryshimet dhe të saksioneve (dënimeve administrative) për ligjin e ri të fiskalizimit dhe zbatimi i këtyre sanksioneve i filloi efektet nga data 1 janar 2022. Pas 10 muaj nga zbatimi i këtyre sanksioneve, propozohet dhjetëfishim i këtyre gjobave për kategorine e biznesit të regjistruar me TVSH dhe tatim fitim.

Nuk e kuptojme analizën e kryer nga Ministria që është konkluduar në dhjetëfishimin e gjobave për vetem një kategori të biznesit. Ne gjykojmë se propozimi për rritjen e gjobave është i pabazuar në ligj dhe antikushtetues.

Së pari, ligji i procedurave përcakton që gjobat e vendosura si shkelje administrative, që lidhen me një detyrim tatimor, nuk mund të kalojnë 100 për qind të detyrimit tatimor, kufirin e përgjithshëm të gjobës të caktuar në nenin 111 “Denimet administrative”, pika 5 e këtij Ligji. Propozimi për dyfishim të gjobave për mosdeklarimin e punonjësve apo pagës reale sjell konflikt të nenit të ligjit të procedurave tatimore që nuk lejon që gjobat e vendosura të tejkalojnë 100%



të detyrimit. Gjithashtu, një shqetesim tjetër është paqartësia për zbatimin e kësaj dispozite dhe barra e proves që duhet të ketë dhe administratat tatimore në momentin e konstatimit të shkeljes për subjektet. Referuar dyfishimit të gjobës për mosdeklarimin e punonjësve dhe fshehja e pagës, ju sjellim në vëmendjen tuaj se Dhoma ka shprehur shqetësimet e saj në lidhje me këtë ndryshim, me anë të letrës së saj zyrtare me nr.32 datë 27 qershor 2022 si dhe në platformën elektronike të konsultimeve publike. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kthyer asnjë përgjigje kundrejt kësaj letre. Lutemi gjeni bashkëngjitur një kopje të letrës nr.32 datë 27 qershor 2022.

Së dyti, për një kategori të caktuar (konkretisht subjektet e regjistruar për TVSH dhe tatim fitim) për moslëshimin e faturës dhjetëfishohen gjobat ndërsa për pjesën tjetër të subjekteve nuk ka ndryshime të sanksioneve. Me propozimet në këtë pakete fiskale, vete ligji do të sjelle trajtime të ndryshme të kategorive të biznesit. Ministria në momentin e propozimit të ndryshimeve për dënimet administrative duhet që të bazohet në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Subjektet tatimpaguese të cilat janë në të njëjtën “shkelje” do të denohen në mënyrë të diferencuar sipas propozimit të fundit, pra nuk do të zbatohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit.

Së treti, për cdo propozim për ndryshim të dënimeve administrative duhet që të merret në konsideratë parimi i proporcionalitetit si një nga parimet më thelbësore kushtetues si dhe parimi kryesor mbi të cilën mbështeten vlerësimet tatimore dhe dënimet administrative. Sipas këtij parimi, dënimet administrative duhet të jenë në përpjestim të drejtë me shkeljen e kryer nga tatimpaguesi. Vetëm duke ruajtur parimin e proporcionalitetit, dënimi për shkelje administrative fiton legjitimitetin dhe për afro masën e dënimit me masën e shmangies tatimore.

Parimi i proporcionalitetit është i përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe përcakton që:

1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:
 - a. i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës;
 - b. i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c. në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Normat e propozuara për moslëshimin e faturës janë përtej normave që parashikon aktualisht legjislacionin tatimor në fuqi si dhe nuk është marrë në konsideratë parimi i proporcionalitetit.

Ashpërsimi i masave të gjobave në fushën e tatimeve ka qenë objekt shqyrtimi i Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 33 datë 08.06.2016 vendosi: Shfuqizimin si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 5, 14, 15, 16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17, pikat 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr. 99/2015 “Për disa ndryshime



dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese konkludon se gjobat e vendosura me ligjin nr. 99/2015 “..... nuk janë proporcionale dhe të arsyeshme për të rivendosur balancën e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit për një ekonomi të formalizuar dhe kërkesave të mbrojtjes së lirisë së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës të tatimpaguesve. Për sa kohë normat ligjore të mësipërme jo vetëm nuk sigurojnë baraspeshën e kërkuar mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik, por përkundrazi e kanë përmbysur atë duke vendosur një barrë të tepruar e të papërbalueshme për subjektet tatimpaguese, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueses për mosrespektimin e parimit të proporcionalitetit në ndërhyrjen ligjore dhe për rrjedhojë cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të së drejtës së pronës, është i bazuar dhe duhet pranuar”.

Gjykata vlerëson në vendim se ashpërsia e gjobave në rastin konkret është e tillë sa ato në thelb shndërrohen në dënime penale. Bazuar në karakteristikat dhe qëllimet e ndryshme midis dënimeve administrative me gjobë të vendosura për një shkelje me natyrë administrative dhe atyre të parashikuara për të njëjtën shkelje kur ajo kualifikohet si vepër penale, Gjykata çmon se kjo masë e ligjvënësit e ka kapërcyer logjikën normale të synimit dhe qëllimit të një mase administrative në fushën e taksave dhe të tatimeve. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se masat e gjobave janë dukshëm të ekzagjeruara dhe jo të përshtatshme për të justifikuar arritjen e qëllimit dhe objektivit për të cilin ato janë parashikuar.

Projekt-ligji që po diskutojmë shkel lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën e pronës njësoj si ligji 99/2015 i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese dhe duhet të rishikohet nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Një argument tjetër është fakti se ashpërsimi i gjobave tatimore rrit automatikisht korrupsionin e administratës tatimore pasi përpara një gjobe të lartë, tatimpaguesi bie më lehtë pre e presionit të administratës tatimore për korrupsion me qëllim shmangien e pagesës së gjobës. Për më tepër, që mosdeklarimi i punonjësve është një shkelje jo e lehtë për t’u verifikuar dhe praktika ka treguar shumë raste kur vendimet e administratës për penalizimin e subjekteve janë shfuqizuar nga Drejtoria e Apelit Tatimor dhe gjykata.

Për sa më sipër, sugjerojmë rishikimin e propozimit për dhjetëfishimin e gjobave dhe të merren në konsideratë komentet tona.

2. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”

Ky ndryshim prek më se shumti prodhuesit shqiptarë të birrës duke qënë se kapacitetet e tyre të prodhimit janë më pak se 200,000 HL/vit. Si pasojë norma e akcizes për prodhuesit vendas të vegjël (pra, me nje prodhim me pak se 200,000 HL/vit), parashikohet të bëhet e njëjtë me importuesit/ prodhuesit e huaj të mëdhenj (pra, me nje prodhim me shume se 200,000 HL/vit).

Relacioni shpreh se këto ndryshime bëhen në kuadër të rekomandimeve të FMN-së. Megjithatë, në këndveshtrimin tonë, sipas Direktives 92/84/KEE te BE, vendeve anëtare iu lejohet të



aplikojnë një normë të diferencuar akcize bazuar në sasi të dhe nivelin e prodhimit vjetor (kufiri i vendosur është 200,000HL). Pra, regjimi aktual i akcizes ka qënë në të njëjtën linjë me lejimet e BE-së dhe nuk ka qënë në kundërshtim me direktivën. Në fakt, unifikimi i akcizës së birrës për të gjithë prodhuesit, pavarësisht nga kapaciteti dhe sasia e prodhimit vjetor do t'i vendosë këta prodhues (sidomos ata vendas që prodhojnë nën 200,000 HL/vit) në disavantazh në raport me prodhuesit e mëdhenj ndërkombëtarë që kanë mundësi të ndjekin strategji të kostove të ulëta si rezultat e ekonomive të shkallës. Jo më kot, BE-ja e ka lejuar një diferencim të tillë, dhe është e paqartë mbi çfarë baze relacioni e konsideron si "favorizuese" normën aktuale të akcizës për prodhuesit vendas të birrës me prodhim më pak se 200,000 HL/vit. Duke konsideruar dhe efektin e pritshëm të përlogaritur nga vete Dogana, mendojmë se nuk është shumë i nevojshëm ky ndryshim, sidomos në këtë periudhë të veshirë ekonomike për tregun në përgjithësi.

Hapesirat e krijuara për shmangie si rezultat i regjimit aktual nuk duhet të perbejnë arsye të rëndësishme për këtë ndryshim, përkundrazi, qeveria, për rastet e abuzimit, duhet të përmirësojë mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit të saj por jo të ndryshojë normat e taksat duke i rritur ato.

3. Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar"

Lutemi gjeni bashkëngjitur letrën nr. 88 datë 19 tetor 2022 për përcjelljen në MFE të komenteve mbi projektligjin e taksave kombëtare.

1. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë"

Përderisa TVSH-ja ngarkohet nga blerësi i energjisë elektrike përmes mekanizmit të reverse-charge (ngarkesa e kundërt), dhe furnizimi është në thelb i tatueshëm e jo i përjashtuar nga natyra, sugjerojmë që në nenin 157 të saktësohet që "furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për t'u shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë" është i tatueshëm me 0% pra si furnizim i ngjashëm me eksportet, ose i përjashtuar por me të drejtën e kreditimit të TVSH-së në blerjet e lidhura me të. Kjo me qëllim për të shmangur koston e TVSH-së së pakreditueshme për furnizuesit e energjisë elektrike, kur qëllimi i skemës është në fakt nxitja dhe lehtësimi i tregtimit të energjisë.



SEKSIONI II

REKOMANDIME TË DHOMËS AMERIKANE - PROPOZIMET TË TJERA PËR TU SHTUAR NË PAKETËS FISKALE 2023

Në vijim të ndryshimeve të propozuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për Paketën Fiskale 2023, po dergojmë përsëri propozimet tona të cilat nuk janë përfshirë në këtë paketë.

- Propozim për qartësim të nenit 121, 123 dhe 124 të ligjit për procedurat tatimore

Duke qënë se nenet 121, 123 dhe 124 të ligjit aktual (sipas nenit 25, 26, 27 të projektligjit), janë rishikuar përsëri mund të jetë momenti për të përcaktuar qartë gjobat që do të aplikohen për moslëshimin e faturave/ autofaturave. Për shembull, sipas pikës 1, shkronjes c, të nenit 123 të ligjit aktual, një person kryen shkelje kur "*nuk lëshon faturë për çdo pranim të mallrave ose të ofrimit të shërbimit, nëse është subjekt i "vetëfaturimit"*", dhe dënohet me një gjobë prej 25,000 - 75,000 leke.

Përdorimi i fjalës "çdo", në mënyrën sesi është shkruar neni, ka shkaktuar konfuzion për gjobën që aplikohet në rastet e moslëshimit të faturave; pra, a është gjoba e aplikueshme për çdo faturë të moslëshuar, apo është një gjobë e vetme? Ne mendojmë që gjoba aplikohet vetëm një herë, dhe jo për çdo faturë të moslëshuar, por duke qënë se neni le vend për interpretim, do ishte mire të thuhej qartazi në ligj në mënyrë që mos të ketë keqinterpretime nga administrata tatimore.

Gjithashtu vlen të theksohet, që sipas ligjit/ udhëzimit të procedurave, ligjit TVSH dhe fiskalizimit, tatimpaguesi duhet të leshojë "faturë nga blerësi" (apo autofaturë), ndër të tjera, për shërbimet që merr nga individë, përndryshe është subjekt i gjobave të mesipërme. Në këndvështrimin tonë, kjo është një proces i tepert dhe pa vlerë, sidomos kur ka kontrata midis paleve, dhe tatimpaguesi është në gjendje të vertetojë pagesat e kryera, qoftë të shpenzimit, qoftë të tatimit në burim (akoma me pa vlerë mund të jete për shembull, për qirata e zyrave të dhena nga individ).

- Propozim për ndryshim të Ligjit nr. 9981, datë 8.9.2008 "Për miratimin e tarifës doganore" i ndryshuar.

Ju lutem gjeni bashkëngjitur me këtë letër projektligjin dhe relacion për ndryshimin e propozuar në ligjin për tarifën doganore.

- Ligji "Për TVSH" dhe ligji "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Propozojmë që të ndryshohen afatet për lëshimin e faturave të fiskalizuara dhe deklarimeve të TVSH si vijon:

- Lëshimi i faturave të lejohet deri në datën 10 të çdo muaji për muajin paraardhës (siç është aktualisht);
- Ngarkimi i Librave të TVSH në "Self care" të mundësohet deri në datën 15, pasi është e pamundur të bëhen rregullimet në libra për faturat e blerjes brenda datës 10, kur edhe



faturat mund të merren në po atë datë. Pra mund të marrësh një ose disa fatura blerje pasditen e datës 10 dhe e ke të pamundur të besh rregullimet në Librin e Blerjes;

- Deklarimi dhe pagesa e TVSH të bëhen brenda datës 20 të çdo muaji. Kjo ul edhe barrën administrative të tatimpaguesve, pasi i bëjnë njëherësh të gjitha pagesat (sigurime, TAP, tatim në burim, TVSH brenda datës 20).

- Furnizimi i shërbimeve për eksport

Ligji për TVSH-në nuk trajton direkt rastin kur furnizuesi i shërbimit është person i tatueshëm (subjekt i TVSH-së) në Shqipëri dhe marrësi i shërbimit është person i tatueshëm jashtë Shqipërisë, por Udhëzimi për TVSH, ka sqaruar që nëse persona të tatueshëm në Shqipëri i furnizojnë shërbime personave të tatueshëm jashtë Shqipërie nuk aplikohet TVSH në Shqipëri.

Por, termi “person i tatueshëm jashtë Shqipërisë” nuk mund të interpretohet bazuar në Ligjin Shqiptar. Në disa vende, psh në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), kompanitë e regjistruara atje paguajnë tatim shitje dhe jo TVSH, pra janë persona të tatueshëm sipas legjislacionit të tyre dhe kjo gjë nuk mund ti “diskriminojë” ato krahasuar me kompanitë që janë të regjistruara për TVSH në shtete të tjera. E thënë ndryshe, diskriminohet eksporti i shërbimeve nga subjekte Shqiptare në SHBA apo edhe në vende të tjera ku nuk ka TVSH por tatim shitje.

Për analogji, eksporti i mallrave trajtohet me TVSH 0%, pamvarësisht ku eksportohet.

Për sa sipër, duhet të ndryshohet neni 23 I Udhëzimit për TVSH në mënyrë që eksporti i shërbimeve nga tatimpagues Shqiptarë për kompani të huaja (B2B) të trajtohet njëloj pamvarësisht nëse eksporti kryhet në vende ku aplikohet TVSH apo tatim shitje, duke e riformuluar si më poshtë:

“Për qëllime të Neneve 23 dhe 24 të këtij Udhëzimi, termi “person i tatueshëm”, kur përdoret për persona të tatueshëm përfitues të shërbimeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të nënkuptojë personat/subjektet e regjistruar si tatimpagues të TVSH-së apo tatimit mbi shitjet sipas legjislacionit tatimor të vendit ku ndodhet subjekti/personi që përfiton shërbimin.

- Çertifikatat e rezidencës

Ligji dhe Udhëzimi “Për Tatimin mbi të Ardhurat” japin kriteret kur një individ mund të konsiderohet rezident tatimor në Shqipëri. Sipas këtyre dispozitave konsiderohet rezident në Republikën e Shqipërisë (RSH) individi që ka një banesë të përherëshme në dispozicion të tij në RSH ose individi që qëndron në RSH më shumë se 183 ditë.

Në faqen e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) janë publikuar procedurat për t'u paisur me çertifikatë rezidence dhe listohen disa kërkesa që tejkalojnë kriteret që jepen në Ligj dhe në Udhëzim. Në Shqipëri ka të huaj që janë të punësuar në kompanitë Shqiptare ose janë të regjistruar si persona fizikë tregtarë në QKB. Në rastin e dytë (kur janë të regjistruar si persona fizikë tregtarë), çertifikata e rezidencës merret menjëherë on-line. Ndërsa individët e

punësuar duhet ta marrin çertifikatën e rezidencës në DPT. Ka individë të punësuar në kompani Shqiptare që kanë mbi 7-8 muaj që kanë bërë kërkesën në DPT për tu paisur me Çertifikatë Residence për vitin 2021 dhe nuk e kanë marrë. Bashkë me kërkesën kanë paraqitur kontratën e punës dhe kontratën e qerasë ku banojnë. Fakti që janë rezidentë tatimorë në Shqipëri, veçse i shton të drejtat tatimore në Shqipëri, por DPT nuk i pais me çertifikata residence dhe kërkon dokumentacion shtesë që Ligji nuk e kërkon dhe që, për më tepër, nuk lëshohet nga autoritetet Shqiptare. Këtë e argumenton me një informacion të publikuar në faqen e internetit të DPT që duhet të ndryshohet.

Pra, për rastet e sipër-përmendura, përveç kontratës së qirasë dhe kontratës së punës (dhe listëpagesave që organet tatimore i kanë), DPT i kërkon këtyre tatimpaguesve edhe hyrje/daljet nga Shqipëria, sipas rekordeve të policisë kufitare. Së pari kjo kërkesë nuk bazohet në ligj dhe në udhëzim, pasi ata i plotësojnë kushtet ligjore për tu konsideruar rezidentë tatimorë në Shqipëri dhe, së dyti, nga interesimet që kemi bërë pranë autoriteteve kompetente (Drejtorisë së Policisë Kufirit dhe AKSHI-t) jemi njoftuar se hyrje-daljet nga RSH mund të merren vetëm nëpërmjet e-albania (nuk ka shërbim në sportele) dhe për shtetasit e huaj është e pamundur të gjenerohet ky informacion nga e-Albania.

Përsa sipër, duhet ti kërkohet Ministrisë së Financave që ti kërkojë DPT-së të azhurnojë faqen e internetit dhe ti jepet çertifikatat e rezidencës individëve të huaj që janë rezidentë tatimorë në Shqipëri (konform ligjit dhe marrëveshjes tatimore) dhe taten në Shqipëri.

- Zbatimi i Marrëveshjeve për eliminimin e taksimit të dyfishtë.

Marrëveshjet për eliminimin e taksimit të dyfishtë (Shkurt: Marrëveshjet tatimore) janë pjesë e legjislacionit tatimor dhe dispozitat e marrëveshjeve tatimore kanë përparësi mbi legjislacionet e brendëshme. Në Shqipëri, nisur nga fakti që dispozitat e marrëveshjeve tatimore kur nisën të zbatohen (në fund të viteve 90) ishin relativisht të vështira për tu kuptuar nga Degët e Tatimeve dhe tatimpaguesit, me Udhëzim të Ministrit të Financave u krijua në DPT një sektor i specializuar që do të ishte përgjegjës dhe do të ndihmonte për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Ky Udhëzim krijoi disa procedura të detajuara dhe kërkonte paraqitjen në DPT të një informacioni shkresor shumë voluminoz dhe mbeti i veçuar nga legjislacioni tatimor në tërësi (përfshirë legjislacionin për transferimin e çmimit), i cili ka shmangur thajse tërësisht dorëzimin e dokumentacionit në letër dhe janë krijuar procedura për deklarimet on line (e-filing) dhe ngarkimin elektronik të dokumentacionit tatimor (përfshirë pasqyrat financiare, formularët e transferimit të çmimit, etj, etj).

Zbatimi i legjislacionit tatimor, gjithnjë e më shumë, bazohet në parimin e vetë-deklarimit/zbatimit nga ana e tatimpaguesve dhe kontrollit me baza rrisht nga organet tatimore. Pra, ndërsa në tërësi legjislacioni tatimor dhe procedurat zbatuese kanë shkuar drejt lehtësisht, informatizimit dhe deklarimeve on-line, zbatimi i Marrëveshjeve Tatimore ka mbetur në vend, madje vitet e fundit procedurat janë përkeqësuar pasi kërkohen në mënyrë të përsëritur dokumentacione voluminoze në letër (kontrata të noterizuara, fatura, formularë, bileta avjoni, etj.) të cilat normalisht duhet të ishin objekt objekt verifikimi nga kontrolli tatimor.

Në këto kushte, Udhëzimi i Ministrit të Financave datë Nr. 6 datë 10.2.2004 "Për marrëveshjet për eliminimin e taksimit të dyfishtë...", duhet të azhurnohet konform dispozitave dhe procedurave tatimore në përgjithsi. Marrëveshjet tatimore, si pjesë e legjislacionit tatimor, duhet të zbatohen normalisht nga tatimpaguesit dhe nga Drejtoritë Rajonale Tatimore, duke deklaruar dhe ngarkuar on-line informacionin e nevojshëm (psh çertifikatat e rezidencës) dhe duke qenë normalisht subjekt i kontrollit tatimor me baza risku.

Tatimpaguesit dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore, sigurisht, bazuar në nenin 10 të Ligjit për procedurat tatimore, mund ti kërkojnë interpretime apo sqarime DPT-së për raste të komplikuar, siç veprohet me çdo dispozitë tatimore.

Udhëzimi i mësipërm duhet të sqarojë gjithashtu një interpretim të gabuar të bërë nga DPT kohët e fundit, sipas të cilit vonesat administrative në depozitimin e disa formularëve (pa efekte tatimore) janë konsideruar si shpenzime të pazbritëshme për kompaninë përfituese të shërbimeve. Ky interpretim i gabuar i DPT është hedhur poshtë disa herë nga Drejtoria e Apelit Tatimor në Ministrinë e Financave dhe DPT vazhdon me të njëjtin qëndrim të gabuar. Problemi duhet detyrimisht të adresohet në Udhëzimin e Ministrit të Financave për Marrëveshjet Tatimore, në mënyrë që edhe marrëveshjet tatimore, ashtu si legjislacioni tatimor në tërësi, të jenë pjesë e deklaramëve elektronike tatimore dhe sigurisht objekt kontrolli nga organet tatimore konform ligjit.

- Çregjistrimi nepermjet likuidimit

Ne perputhje me nenin 45 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar, parashikohet ndër të tjera se tatimpaguesit persona juridike/fizike, të cilët kryejnë veprimtari ekonomike fitimprurëse, çregjistrohen sipas dispozitave të ligjit "Për Qendren Kombëtare të Biznesit" dhe pas kryerjes prej tyre të procedurave të likuidimit të njohura nga ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kërkesa për çregjistrim paraqitet në QKB, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin "Për Qendren Kombëtare të Biznesit".

Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), menjëherë me marrjen e kërkesës për çregjistrim prej tatimpaguesit, njofton organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit ose për kërkesën për çregjistrim të personit fizik apo për aplikimin për çregjistrim të personit juridik, edhe kur kemi të bëjmë me aplikimin për çregjistrim pa kryerjen e likuidimit.

Në momentin e dorëzimit të raportit përfundimtar dhe të bilancit të likuidimit prej likuiduesit në Qendren Kombëtare të Biznesit, kjo e fundit njofton administratën tatimore. Me marrjen e këtij njoftimi, tatimpaguesit nuk i gjenerohen me deklarata tatimore nga sistemi për periudhën pasardhëse. Administrata tatimore, brenda **10 ditëve pune** nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të personit juridik/fizik. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtroje kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtari subjektin, atëherë ky afat nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë pune,



perfshire kryerjen e kontrollit. Qendra Kombetare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 30-ditor, të përmendur më sipër, administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore **tregon shumen e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit**, ose nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore. Kundërshtimi nga administrata tatimore është i vlefshëm dhe kur dërgohet elektronikisht sipas protokollit elektronik të shkëmbimit të të dhënave midis QKB-së dhe administratës tatimore.

Nese organi tatimor nuk i pergjigjet QKB-se ose gjykates brenda afatit, QKB-ja ose gjykata çregjistrohet automatikisht subjektin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin. Në rastin kur subjektet e regjistruara pranë Qendres Kombetare të Biznesit ose gjykates rezultojnë me detyrime tatimore, ato çregjistrohen automatikisht pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në momentin kur subjekti paguan detyrimet tatimore, organi tatimor menjëherë njofton QKB-në ose gjykatën dhe subjektin, që subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Në rastin kur kundërshtimi për çregjistrim nga organet tatimore është bërë si pasoje e mosdorëzimit të pasqyrave financiare ose deklaratave tatimore, atëherë, me paraqitjen e tyre, organi tatimor kompetent detyrohet të tërheqë menjëherë kundërshtimin për çregjistrim dhe QKB-ja kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit. Nëse, pavarësisht nga shlyerja e detyrimit, për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi, organi tatimor kompetent nuk ka tërhequr kundërshtimin, atëherë subjekti paraqet pranë QKB-së dokumentin që verteton shlyerjen e këtyre detyrimeve tatimore. Në këtë rast, QKB-ja kryen menjëherë çregjistrimin e subjektit dhe njofton menjëherë organin tatimor kompetent dhe tatimpaguesin.

Për çdo procedurë që organi tatimor dhe QKB-ja kryejnë, sipas ligjit dhe udhëzimit, që kur fillon procedura e çregjistrimit dhe deri në çregjistrimin përfundimtar, njoftojnë në të njëjtën kohë edhe tatimpaguesin. Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet QKB-së ose gjykates brenda afatit, QKB-ja ose gjykata çregjistrohet automatikisht subjektin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin. Në këtë rast, përgjegjësia është e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, drejtori i së cilës nxjerr përgjegjësinë personale të punonjësve të tatimeve dhe propozon masat përkatëse ligjore disiplinore apo penale ndaj tyre. Për çdo çregjistrim të personave të tatueshëm, Qendra Kombetare e Biznesit njofton Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit përkatës.

Megjithatë, edhe pse baza ligjore më sipër shpjegon qartazi të gjithë procedurën, çregjistrimi është një problematike e theksuar e hasur me vite nga administrata tatimore për subjekte të likuiduara nga QKB/Gjykata. Shpeshherë nuk zbatohet neni 45 më sipër për sa i takon çregjistrimit, ku shprehimisht thuhet **së data e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në QKB ose në Gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.**

Nderkohe që Administrata Tatimore, dërgon shkresë për kryerje të kontrollit tatimor e vizitave fiskale edhe pas kësaj date, kur sipas ligjit kjo procedurë sipas një analize të rrishtit duhet të kryhet përpara datës së çregjistrimit nga QKB/Gjykata dhe nëse kryhen mbrapa, likuidatori nuk ka më asnjë tregër



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE
DHOMA AMERIKANE E TREGTISË

per te perfaqesuar nje subjekt tashme te çregjistruar, aq me teper kur eshte larguar nga detyra me miratimin e fazes se dyte te likuidimit ne QKB ose Gjykate.

Propozimi

Mendojme qe ne nenin 45 duhet te shtohet fjalia: “...Per te gjithë tatimpaguesit qe rezultojne te çregjistruar nga QKB, Gjykata apo organet e tjera kompetente, te cilet nuk kane detyrimeve tatimore te papaguara, dhe ne rastin e personit juridik, faktin se ai ka paraqitur pasqyrat financiare te mbylljes se aktivitetit deri ne momentin e likuidimit, kane dorezuar deklaratat tatimore dhe/ose nuk kane kredi tatimore ne sistemin tatimor ose kane paraqitur nje deklaratë me shkrim per heqjen dore prej tyre, çregjistrohen ***automatikisht*** nga regjistri tatimor”.

Gjithashtu, “...Per te gjithë tatimpaguesit e cregjistruar tashme nga QKB, Gjykata apo organet e tjera kompetente, te cilet permbushim percaktimet e si me siper, para dates se hyrjes ne fuqi te ketij ndryshimi, çregjistrohen ***automatiskisht*** nga regjistri tatimor”.

Pra, do ishte e udhes qe te kryhej nga ana e Administrates Tatimore nje fshirje nga regjistri tatimor i te gjithë tatimpaguesve te cilat rezultojne te çregjistruar nga QKB/Gjykata etj., te cilet nuk kane çeshtje te hapura apo detyrime prane saj.